



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 15.08.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **07.08.2023**, të parashtruar nga operatori ekonomik **N.N.SH VIZION PROJECT**, me shifren **1412**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Konkurs projektimi për Nderimin e QKMF Shtime” me nr prokurimi 206-23-5282-2-2-3, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e operatori ekonomik **N.N.SH VIZION PROJECT**, me shifren **1412** e dt. 07.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Konkurs projektimi për Nderimin e QKMF Shtime” me nr prokurimi 206-23-5282-2-2-3, kundër NJOFTIMI PËR REZULTATET E KONKURSIT TË PROJEKTIMIT - REZULTATET E VLERËSIMIT ARTISTIK të datës 02.08.2023 të publikuar në platformën elektronike.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI PËR REZULTATET E KONKURSIT TË PROJEKTIMIT i datës 02.08.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit*;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori ekonomik **N.N.SH VIZION PROJECT**, me shifren **1412** me date 07.08.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Konkurs projektimi për Nderimin e QKMF Shtime” me nr prokurimi 206-23-5282-2-2-3. Autoriteti Kontraktues, me datë 15.08.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

- Neni 7 Barazia në Trajtim / Jo — Diskriminimi
- Neni 10 Mjetet për promovimin e transparencës
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe krahasimi i tendereve
- Neni 60 Kriteret për dhënien e kontratës

AK ka shkelur edhe dispozitat e RREGULLAVE dhe UDHËZUESIT OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK:

20. Specifikimet Teknike

41. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Pretendimet ankimore

Argumenti 1:

Mosrespektimi i rregullativës ligjore në fuqi të planifikimit hapësinor dhe kritereve hapësinore sic iane paraparë në detyren projektuese dhe specifikat teknike nga ana e projekteve pjesëmarrëse në konkursin e projektimit

Bazuar në Detyrën Projektuese të "Konkurs projektimi për ndërtimin e QKMF Shtime", nga OE-të që synonin pjesëmarrjen në këtë konkurs projektimi, AK- Ministria e Shëndetësisë kërkon që "Distanca e objektit nga kufiri i parces min. lh (h=lartësia bruto e objektit mbi parter) dhe Planifikimi i objektit duhet të bëhet duke i marr parasysh qasjen vetëm nga rruga "Tahir Sinani "

PO ashtu në Detyrën Projektuese, AK- Ministria e Shëndetësisë si informatë shtesë është potencuar dhe kërkon nga të gjithë projektuesit pjesëmarrës që:

.kompania projektuese duhet te konsultoj planifikimet urbane të Komunës se Shtimes dhe legjislacionin tjetër ne fuqi per hapësirat dhe koeficientet e lejuar brenda sipërfaqes se përgjithshme te lokacionit te përcaktuar"

Siç vërehet qartë, projektet ideore me shifrat 8485, A3P7, 0306, 3005, 1208 dhe 8719 nuk kanë respektuar këto kritere dhe obligimet Wore që kanë të bëjnë me planifikim hapësinor dhe detyrën projektuese, po ashtu nuk kanë respektuar Nenin 20.9 Specifikimet Teknike të RRUOP-së për arsye se:

1a)

- Projektuesi me shifrën 8485 në projektin e tij ne fleten ku është paraqitur dhe dimesnionuar situacioni, nga ana perëndimore e parcelës megjithëse kërkohe minimum të largohet nga pacela fqinjë 8.4m, ai është larguar 5.18 në njëren pikë dhe 7.45 në pikën tjetër, ndërsa në anën veriore do duhej të largohej min. 12.6m ai është larguar 9.19m, që është në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore në fuqi të planifikimit hapësinor dhe detyrën projektuese ku kërkohe që: "*Distanca e objektit nga kufiri i parces min. lh (h:lartësia bruto e objektit mbi parter)* "

1b)

- Projektuesi me shifrën A3P7 në projektin e tij në fletën ku është paraqitur dhe dimensionuar situacioni, nga ana veriore e parcelës megjithëse kërkohe minimum të largohet nga pacela fqinjë 13m, ai është larguar 12.27m ndërsa nga pjesa jugore e parcelës qe kufizohet me rrugen "Tahir Sinani" nuk ka vendosur distance se sa është larguar, mirëpo vërehet se nuk është larguar 20m ashtu sic kerkohet nga planet në fuqi, që është në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore në fuqi të planifikimit hapësinor dhe detyrën projektuese ku kërkohe që: "*Distanca e objektit nga kufiri i parcelës min. lh (h—lartësia bruto e objektit mbi parter)* "

1c)

- Projektuesi me shifrën 0306 në projektin e tij në fletën ku është paraqitur dhe dimesnionuar situacioni, nga ana veriore e parcelës megjithëse kerkohet minimum të largohet nga pacela fqinjë 13m, ai është larguar 10.0 m në njëren pikë dhe 12.92m në piken tjetër, po ashtu ku projekt ka ofruar casje nga ana perëndimore e parcelet duke kaluar përmes sheshit ekzistues që është në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore në fuqi të planifikimit hapësinor dhe detyrën projektuese ku kërkohe që: "*Distanca e objektit nga kufiri i parces min. lh (h—lartësia bruto e objektit mbi parter)* ", "Planifikimi i objektit duhet të bëhet duke i marr parasysh qasjen vetëm nga rruga "Tahir Sinani "

1d)

- Projektuesi me shifrën 3005 në projektin e tij në fletën ku është paraqitur dhe dimesnionuar situacioni, nga ana veriore e parcelës megjithëse nuk e ka vendosur dimension se sa metra është larguar nga kufiri i

parceles prap vërehet se nuk e ka permbushur kriterin e kërkuar, ndërsa nga pjesa jugore e parcelës që kufizohet me rrugën "Tahir Sinani" nuk ka vendosur distancë se sa është larguar, mirëpo vërehet se nuk është larguar 20m ashtu sic kërkohej nga plani në fuqi, po ashtu ky projekt e ka shkelur edhe një kriter tjetër të rëndësishëm të detyrës projektuese ku kërkohej që "Planifikimi i objektit duhet të bëhet duke i marrë parasysh qasjen vetem nga rruga "Tahir Sinani", ai ka bërë casje edhe nga një rrugë tjetër nga ana lindore e parcelës që është në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore në fuqi të planifikimit hapësinor dhe detyrën projektuese ku kërkohej që: "*Distanca e objektit nga kufiri i parcelës min. I_h (h=lartësia bruto e objektit mbi parter)* ", "*Planifikimi i objektit duhet të bëhet duke i marrë parasysh qasjen vetem nga rruga "Tahir Sinani "*

1e)

- Projektuesi me shifrën 1208 në projektin e tij në fletën ku është paraqitur dhe dimensionuar situacioni, nga ana veriore e parcelës dhe pse nuk ka vendosur dimensione që tregojnë distancën nga kufiri i parcelës, vërehet se nuk është larguar sa duhet kështu që është në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore në fuqi të planifikimit hapësinor dhe detyrën projektuese ku kërkohej që: "*Distanca e objektit nga kufiri i parcelës min. I_h (h=lartësia bruto e objektit mbi parter)* ".

1f)

- Projektuesi me shifrën 8719 në projektin e tij në fletën ku është paraqitur dhe situacioni nuk e ka marrë parasysh kufirin e parcelës dhe nuk e ka paraqitur fare atë në vizatimet e tij, kështu që është në kundërshtim me kërkesat e detyrës dhe nuk mund të kuptohet nese i ka plotësuar dispozitat ligjore në fuqi të planifikimit hapësinor dhe detyrën projektuese ku kërkohej që: "*Distanca e objektit nga kufiri i parcelës min. I_h (h=lartësia bruto e objektit mbi parter)* ' "

Edhe përkunder se Projektet me shifrat 8485, A3P7, 0306, 3005, 1208 dhe 8719 kanë shkelur të gjitha distancat e objektit karshi parcelës serish Komisioni Vlerësues i Projekteve i ka poentuar me pike maksimale dhe me të larta se projektin me shifrën 1412 i cili projekt është i vetmi që ka respektuar këtë kriter të Detyrës Projektuese duke respektuar distancat e kërkuara sipas DP.

Me këto veprime të paligjshme, Juria Profesionale ka shkelur edhe nenin 41.3 të RREGULLAVE dhe UDHËZUESIT OPERATIV PËR PROKURIMIN PUBLIK, ku thuhet se "Tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kushtet obligative teknike të specifikuar " si dhe pikën 41.5, pika b të këtyre Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik ku thuhet se "*Tenderi konsiderohet të jetë i përgjegjshëm kur: është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit.*

Argumenti 2:

Mosrespektimi i Detyrës Projektuese, specifikave teknike dhe kriterëve profesionale të projektimit të ndërtesave shëndetsore

Bazuar në Detyrën Projektuese të "*Konkurs projektimi për ndërtimin e QKMF Shtime*", nga OE-të që synonin pjesëmarrjen në këtë konkurs projektimi, AK- Ministria e Shëndetësisë kërkon dhe paraqet kërkesa shumë specifike që nuk janë respektuar nga projektet me shifrat 8485, A3P7,0306, 3005, 1208 dhe 8719

Në Detyrën Projektuese tek kapitulli VIII "NDËRTIMI QENDRËS KRYESORE TE MJEKËSISË FAMILJARE DHE SHËRBIMEVE URGJENTE NE SHITIME" nga faqe 18 deri në faqe 26 të dosjes së tenderit janë paraqitur kërkesat e detyrës projektuese të cilat do duhet të respektohen nga OE. Siç vërehet qartë, projektet ideore me shifrat 8485, A3P7, 0306, 3005, 1208 dhe 8719 nuk kanë respektuar këto kriterë dhe obligime të detyrës projektuese dhe specifikat teknike të kërkuara për arsye se:

2a)

- Projektuesi me shifrën 8485 nuk ka respektuar detyrën projektuese dhe specifikat teknike të kërkuara ku kërkohej:

Dhoma e triazhimit me min. dy krevate - 40 m² , projekti në fialë e ka paraparë këtë hapësirë si pjesë të korridorit të urgjencës e jo dhomë sic e kërkon detyra projektuese.

Hyrja e veqant ne zonen e mjeksis familjare — erembrojtesi hyres 15m², projekti në fjalë e ka paraparë këtë hapësirë me sipërfaqe 10m² , në këtë mënyrë e ka shkelur detyren projektuese.

Mjekësia Familjare Nyjet sanitare - 3 per pacient M(1)/F(2) (tualeti per meshkuj te kete min. 2 pisuar), ne afersi te kete dhe nje EC per persona me aftesi te kufizuara, projekti në fjalë e ka paraparë vetëm 1 tualet per femra, në këtë mënyrë e ka shkelur detyren projektuese.

Mjekësia Familjare Nyjet sanitare per personel, M(I)/F(I), tualeti per meshkij (M) te kete se paku nje pisuar, projekti në fjalë nuk e ka paraparë 1 pisuar tek tualeti për me shkruj, në këtë mënyrë e ka shkelur detyren projektuese.

Objekti i QKMF-se duhet te kete max. 4 1 hyrje ((sherbimi ambullantor; urgjenca; personeli dhe ekonomike) Hyrja ne diagnostike — si mundesi shtese). Duhet te parashifet edhe nje hyrje per rastet e jashtezakonshme (hyrja 5) per raste te veqanta per qasje ne zonen e vaksionimit, projekti në fjalë ka paraparë gjithësej 7 hyrje në këtë mënyrë e ka shkelur detyren projektuese.

Te pjesa e laboratorit ...nje hapsire per mirmbajtje hixhenike, projekti në fjalë nuk e ka paraparë fare këtë kthinë, në këtë mënyrë e ka shkelur detyren projektuese.

Te Hapsirat per edukim dhe promovim shendetesor Tuatele per staf dhe mysafir M(1)/F(2)/1(handicap) dy pisuar per (M), projekti në fjalë e ka paraparë vetëm 1 tualet per femra, në këtë mënyrë e ka shkelur detyren projektuese.

2b)

- Projektuesi me shifrën A3P7 nuk ka respektuar detyrën projektuese dhe specifikat teknike te kerkuara ku kerkohet:

Te mjeksia familjare 2 Ordinanca (2x min. 32m² =2 x min. (16m² 16m²)) dhe 2 Ordinanca (2x min. 32m² =2 x min.(16m² 16m²)), projekti në fjalë ka paraparë vetem 2 ordinanca në projektin e tij në këtë mënyrë e ka shkelur detyren projektuese.

Te Administrata Doma per IT— min. 12 m² projekti në fjalë nuk ka paraparë fare këte hapësirë në këtë mënyrë e ka shkelur detyren projektuese.

Te Sherbimi i miëmbajtjes Dhome per punetoret teknikë - 20 m² me banjo te perbashket, projekti në fjalë nuk ka paraparë banjo mirëpo vetem tualet në këtë mënyrë e ka shkelur detyren projektuese.

Te Sherbimi i Urgjencës Dy toalete perpersonelin shendetesor, M(I) dhe F(I), perfshi dhe 2 garderoba (zhveshtore) ne afersi projekti në fjalë nuk ka paraparë fare garderoba për personalin në këtë mënyrë e ka shkelur detyren projektuese.

Te Sherbimi i Urgjencës Nje tush banjo per nevoja urgjente hixhenike, e paisur me guask dhe nje Lavaman, projekti në fjalë nuk ka paraparë fare këtë hapësirë në këtë mënyrë e ka shkelur detyren projektuese.

2e)

- Projektuesi me shifrën 0306 nuk ka respektuar detyrën projektuese dhe specifikat teknike te kerkuara ku kerkohet:

Te Laboratori Korridor nderlidhes dhe pritore per laboratorin, projekti në fjalë nuk ka paraparë fare pritore në këtë pjesë në këtë mënyrë e ka shkelur detyren projektuese.

Te Laboratori dhe Diagnostika kerkohen TuateletperpacientM(1)/F(1), tualeti per meshkuj (M) te kete sepaku nje pisuar dhe Tuatelet per pacient M(1)/F(1), tualeti per meshkuj (M) te kete se paku nje pisuar, projekti në fjalë ka paraparë vetëm 1 tualet për femra dhe një për meshkuj në këtë pjesë në këtë mënyrë e ka shkelur detyren projektuese.

Te Sherbimet e mirëmbatjes kerkohen Arkivi — te jete ne dy zona, depo e arkivit per ruajtje te gjate min. 30m² dhe nje arkiv doracak per materiale ne perdorim me sip. min. 20m²., projekti në fjalë ka paraparë vetëm 1 kthinë e Cila ka 36m² (jo 50m²) dhe nuk ëshë e ndarë sic kërkohet ne detyrë në këtë mënyrë e ka shkelur detyren projektuese.

PO ashtu te pjesa e laboratorit Shefi i laboratorit dhe - Nje dhome per takime me kuzhin

çaji janë vendosur tek pjesa e diagnostikës dhe jo si pjesë e laboratorit.

2d)

- Projektuesi me shifrën 3005 nuk ka respektuar detyrën projektuese dhe specifikat teknike të kërkuara ku kërkohe:

Te Mjekësia Familjare Nyjet sanitare - 3 për pacient M(1)/F(2) (tualeti për meshkuj të kete min. 2 pisuar), në afërsi të kete dhe një ËC për persona me aftësi të kufizuara, projekti në fjalë ka paraparë vetëm 1 pisuar në këtë mënyrë e ka shkelur detyrën projektuese.

Te Sherbimet Stomatologjike Dy zhveshtore — garderobe për staf (Meshkuj dhe Femra) për nevojat e stafit mjeksor, projekti në fjalë nuk ka paraparë fare garderoba për personel në këtë mënyrë e ka shkelur detyrën projektuese.

Te Sherbimet Tualet për staf dhe mysafir M(1)/F(2)/I(handicap) dy pisuar për (M), projekti në fjalë ka paraparë vetëm 1 pisuar në këtë mënyrë e ka shkelur detyrën projektuese.

Te Sherbimi i mirëmbajtjes Dhome për punetoret teknikë - 20 m² me banjo të përbashkëta, projekti në fjalë nuk ka paraparë fare banjo në këtë mënyrë e ka shkelur detyrën projektuese.

Te Sherbimi i mirëmbajtjes Jashtë gabaritet të objektit (QKMF-së) të parashifen dy hapësira (2x10m²) për deponim të mbetjeve medicinale... dhe Jashtë gabaritet të objektit të QKUM-se të parashifet dhe hapësit me mbulesë të lehtë për pozicionim të gjeneratorit mobil projekti në fjalë nuk ka paraparë fare këto hapësira në projektin e tij në këtë mënyrë e ka shkelur detyrën projektuese.

Te Laboratori Jashtë gabaritet të objektit (QKMF-së) të parashifen dy hapësira (2x10m²) për deponim të mbetjeve medicinale... dhe Jashtë gabaritet të objektit të QKUM-se të parashifet dhe hapësit me mbulesë të lehtë për pozicionim të gjeneratorit mobil projekti në fjalë nuk ka paraparë fare këto hapësira në projektin e tij në këtë mënyrë e ka shkelur detyrën projektuese.

2e)

- Projektuesi me shifrën 1208 nuk ka respektuar detyrën projektuese dhe specifikat teknike të kërkuara ku kërkohe:

Te Mjekësia Familjare Nyjet sanitare - 3 për pacient (tualeti për meshkuj të kete min. 2 pisuar), në afërsi të kete dhe një ËC për persona me aftësi të kufizuara, projekti në fjalë ka paraparë vetëm 1 pisuar në këtë mënyrë e ka shkelur detyrën projektuese.

Te Laboratori Korridor nderlidhës dhe pritore për laboratorin, projekti në fjalë ka paraparë pritore fare në këtë mënyrë e ka shkelur detyrën projektuese.

Te Hapsirat për edukim dhe promovim shëndetësor Tualet për staf dhe mysafir M(1)/F(2)/I(handicap) dy pisuar për (M), projekti në fjalë ka paraparë vetëm një tualet për femra dhe nuk ka paraparë fare pisuar në këtë mënyrë e ka shkelur detyrën projektuese.

Te Holli i urgjencës rreth 70m², përfshi pritoren ... projekti në fjalë nuk ka paraparë fare pritore të pjesës së urgjencës në këtë mënyrë e ka shkelur detyrën projektuese.

Te Sherbimi i mirëmbajtjes Depo e veqante për nevojat e urgjencës, në brendi të kete një boks me dy njësi për vendosjen e pacientve pajetë kur dojete e nevojshme deri të sherbimet në vazhdim — min. 16 m², projekti në fjalë nuk ka paraparë fare këtë hapësirë në këtë mënyrë e ka shkelur detyrën projektuese.

Te Laboratori Korridor nderlidhës dhe pritore për laboratorin, projekti në fjalë nuk ka paraparë fare pritore në këtë pjesë në këtë mënyrë e ka shkelur detyrën projektuese.

Te Laboratori dhe Diagnostika kerkohen Tualetet për pacient M(I)/F(I), tualeti për meshkuj (M) të kete se paku një pisuar dhe Tualetet për pacient M(I)/F(I), tualetit për meshkuj (M) të kete se paku një pisuar, projekti në fjalë ka paraparë vetëm 1 tualet për femra dhe një për meshkuj në këtë pjesë në këtë mënyrë e ka shkelur detyrën projektuese.

2f)

- Projektuesi me shifrën 8719 nuk ka respektuar detyrën projektuese dhe specifikat teknike te kerkuara ku kerkohet:

Te Mjekësia Familjare Hapsina per dhanjen e infuzioneve, min. 25m2 - 3 krevate, projekti në fjalë nuk ka paraparë fare këtë hapësirë në këtë mënyrë e ka shkelur detyren projektuese.

Te Mjekësia Familjare Barnatorja per sherbim pacientve, projekti në fjalë nuk ka paraparë fare këtë hapësirë në këtë mënyrë e ka shkelur detyren projektuese.

Te Mjekësia Familjare Ordinanca e vaksionimit — (min.)2x16 m2, projekti në fjalë nuk ka paraparë fare këtë hapësirë në këtë mënyrë e ka shkelur detyren projektuese.

Te Laboratori Tualetet per meshkuj dhe femra —personeli i laboratorit, perfshi garderobat, projekti në fjalë nuk ka paraparë fare garderoba për personel në këtë mënyrë e ka shkelur detyren projektuese.

Te Laboratori Hapsir pune per analiza laboratorike (min.) 25m2, projekti në fjalë nuk ka paraparë fare këte hapësirë në këtë mënyrë e ka shkelur detyren projektuese.

Te Laboratori Hapsir pune per administrim te laboratorit (min.) 8m2, ne lidhje permes sportelit me korridorin per marrjen e rezultateve te analizave, projekti në fjalë nuk ka paraparë fare këte hapësirë në këtë mënyrë e ka shkelur detyren projektuese.

Te Sherbimi i mirëmbajtjes Shefi i mirmbajtjes — 16 m2, projekti në fjalë nuk ka paraparë fare këte hapësirë në këtë mënyrë e ka shkelur detyren projektuese.

Te Sherbimi i mirëmbajtjes Dhome per punetoret teknike - 20 m2 me banjo te perbashket, projekti në fjalë nuk ka paraparë fare këte hapësirë në këtë mënyrë e ka shkelur detyren projektuese.

Te Sherbimi i mirëmbajtjes Jasht gabaritit te objektit (QKMF-së) te parashifen du hapsira (2x10m2) per deponim te mbetjeve medicionale dhe Jasht gabaritit te objektit te QKUMse te parashifet dhe hapsit me mbules te lehteperpozicionim te gjeneratorit mobil, projekti në fjalë nuk ka paraparë fare këto hapësirë në këtë mënyrë e ka shkelur detyren projektuese.

- Projektuesi me shifrën 8719 nuk ka treguar fare sipfaqet neto të hapësirave dhe duket sikur ka shkelur edhe sipërfaqet minimale të kërkuara nga detyra projektuese, po ashtu nuk ka emruar disa hapësira dhe nuk mund të vlersohet drejtë ky projekt!

Me këto veprime të paligjshme, Juria Profesionale ka shkelur edhe nenin 41.3 të RREGULLAVE dhe UDHËZUESIT OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK, ku thuhet se "Tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kushtet obligative teknike të specifikuara " si dhe pikën 41.5, pika b të këtyre Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik ku thuhet se "*Tenderi konsiderohet të jetë i përgjegjshëm kur: është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit.*

Argumenti 3:

Mosrespektimi i Detyrës Projektuese dhe dispozitat ligjore të RREGULLORES Nr. 24/2012 PËR NORMAT TEKNIKE PËR MBROJTJE NGA ZJARRI TË OBJEKTEVE TË LARTA:

Bazuar në Detyrën Projektuese të "Konkurs projektimi për ndërtimin e QKMF Shtime", nga OE-të që synonin pjesëmarrjen në këtë konkurs projektimi, AK- Ministria e Shëndetësisë kërkon ne detyren projektuese "Shkalle per evakuim emergjent (kunder zjarrit) ... "ndersa te njejtat edhe pse jan paraqitu në pjesen grafike të projekteve me shifrat 8485, A3P7, 0306, 3005, 1208 dhe 8719 ato përsëri nuk kan menduar dhe projektuar si duhet keshtu kan bere shkelje te rregulloreve te pergjithshme.

Duke u bazuar "RREGULLOREN Nr. 24/2012 PËR NORMAT TEKNIKE PER MBROJTJE NGA ZJARRI TE OBJEKTEVE TE LARTA" verehet se, projektet ideore me shifrat 8485, A3P7, 0306, 3005, 1208 dhe 8719 kan shkelur:

Neni 21 1. Hapsira e shkalleve duhet te kete hapje per ajrosje natyrore, te cilat hapen nga kati perdhes ose nga pushimoret ne shkalle.

Neni 32 3. Te gjitha daljet nga objekti duhet të qojne drejtperdrejte ne rruge, oborr ose ne ndonje hapesire te sigurt.

Neni 33 2. Dyert duhet te jene te vendosura ne menyre qe ne çdo kohe mund te hapen nga ana e cila duhet të dalim.

Argumenti 4:

Vlerësimi jo i bazuar ne 5 nenkriteret e vleresimit per koncept projektet

Bazuar ne Dosjen e tenderit te "Konkurs projektimi per ndertimin e QKMF Shtime", jan jepur edhe kriteret e vleresimit te propozimit teknik te cilin juria nuk e ka marre parasysh fare dhe ne kete menyre ka shkelur Nenin 7 te Ligjit Per PP.

4a)

Kriteri i pare te propozimi teknik eshte: **Kriteri hapesinor (40)**

Megjithese projektet me shifrat **8485, A3P7, 0306, 3005, 1208 dhe 8719** kan bere shkelje te rregullativës ligjore ne fuqi te planifikimit hapesinor dhe kriterëve hapesinore sic jane parapare ne detyren projektuese ata prap kan marre pike maksimale (31.97; 26.53; 20.20; 2647; 18.43; 20.17) ndersa projekti me shifren 1412 ka respektuar te kriteret dhe kerkesat e detyres tek "Kriteri i hapesires" ky projekt prap merr piket minimale (15.20).

4b)

Kriteri i dyte te propozimi teknik është: **Kriteri programor (20)**

Megjithese projektet me shifrat 8485, 0306, 3005, 1208 kan bere shkelje te detyres projektuese duke mos ju permbajtur kerkesave te detyres ata prap kan marrë pikë maksimale (17.11; 18.17; 10.39; 10.78) ndersa projekti me shifren 1412 ka respektuar te gjitha kriteret dhe kerkesat e detyres tek "Kriteri i hapesires" ky projekt prap merr piket minimale (7.55)

4c)

Kriteri i trete te propozimi teknik është: **Kriteri Ekonomik (20)**

Megjithese ne si OE me shifren 1412 ka ofruar nje forme kompakte dhe shfrytezim racional te hapesirave dhe ka ofruar nje kosto te ndertim rreth 1.5 mln euro, prap eshte vlersuar me vetem (6.41) per dallim me projektet tjera qe kan ofruar kosto me te larte te ndertimit dhe forme jo racionale te njejtin prap kan marre piket maksimale nga juria.

4d)

Kriteri i katert te propozimi teknik është: **Kriteri i lëvizshmërisë (10)**

Megjithese ne si OE me shifren 1412 ka ofruar nj zgjidhje te pershtatshme duke i iu jepr prioritet levizjes se këmbësoreve dhe urgjences prap është vlersuar me vetem (6.41) per dallim nga projektet tjera qe kan marre pike maksimale.

4e)

Kriteri i peste te propozimi teknik është: **Kriteri estetik dhe ekologjik — arkitekturë e qëndrueshme (10)**

Megjithese ne si OE me shifren 1412 ka ofruar nje arkitekturë te qendrueshme duke perdoru brisole vertikale qe ndihmojne ne kursim e energjise, perdorimin e paneleve solare, kulmeve te gjelberta si dhe duke perdorur materiale te riciklueshme duke u munduar te krijojë nje ambient sa me ekologjike prap eshte vlersuar me vetem (596) per dallim me projektet tjera kan perdorur vetem panele solare dhe asgje tjeter prap kan marre pike maksimale (9.33; 8.33; 7.50; 9.04).

Prandaj, deshmohet qarte se duke vlersuar me pike maksimale koncept projektet me shifrat 8485, A3P7, 0306, 3005, 1208 dhe 8719, projekte këto që siç dëshmuam me larte nuk kane respektuar SPECIFIKIMET TEKNÏKE dhe/ose estetike TE DETYRUESHME te Dosjes se Konkursit te Projektimit per kete aktivitet prokurimi, Juria Profesionale e caktuar nga AK-Ministria e Shëndetësisë ka shkelur dispozitat ligjore te Ligjit per Prokurim Publik, përkatësisht Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, përkatësisht pikin 4 të këtij neni ku kërkohet decidivisht që "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm

nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”.

KONKLUZION

Si konkluzion mund të thuhet se Juria Profesionale e caktuar nga MINISTERIA E SHËNDETËSISË përmes mosvlerësimit të drejtë të projekteve pjesëmarrëse në këtë konkurs projektimi, duke na diskriminuar rrënjësisht neve si OE pjesëmarrës në këtë konkurs projektimi dhe duke shpallur fitues dhe vlerësuar me pikë maksimale projektet që nuk kanë respektuar kërkesat e Detyrës projektuese dhe rregullativën ligjore në fuqi, ka shkelur rëndë dispozitat ligjore të LPP-së.

Prandaj, duke pasur parasysh se vendimi i AK-së lidhur me këtë konkurs projektimi është i paqëndrueshëm ligjërisht dhe profesionalisht, dhe duke pasur parasysh po ashtu se projektet me shifrat 8485, A3P7, 0306, 3005, 1208 dhe 8719 bazuar në mosrespektimin e kërkesave të Detyrës Projektuese dhe Nenit 20.9 Specifikimet TelQIike sipas RRUOP të këtij konkursi projektimi dhe rrjedhimisht edhe të rregullativës ligjore në fuqi, janë projekte të

Kërkojmë nga AK- MINISTERIA E SHËNDETËSISË që këtë konkurs projektimi ta kthejë në rivlerësim dhe të shpallë fituesin e këtij konkursi të projektimit nga projektet e përgjegjshme që kanë respektuar kërkesat e Detyrës Projektuese dhe rregullativës ligjore në fuqi.

Më këto veprime, AK- MINISTERIA E SHËNDETËSISË ka shkelur dispozitat ligjore të Ligjit të Prokurimit Publik lidhur me vlerësimin e pavarur dhe të drejtë e te barabartë, përkatësisht këto nene të LPP-së:

AK ka shkelur dispozitat e LPP ne

Neni 7 Barazia në Trajtim / Jo — Diskriminimi

Neni 10 Mjetet për promovimin e transparences

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

Neni 60 Kriteret për dhenjen e kontratës

AK ka shkelur edhe dispozitat e RREGULLAVE dhe UDHËZUESIT OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK:

20. Specifikimet Teknike

41. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Dëmet materiale

Me këto vendime të Komisionit Vlerësues të AK Ministria e Shendetësisë neve na janë shkaktuar dëme në vlerë prej 5,000.00 Euro për Pergaditjen e Koncept Projekteve dhe Dokumentacionit të Kandidatit

Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues në lidhje me pretendimin Ankimorë

I kemi shqyrtuar pretendimet ankimore të Kërkesës tuaj për Rishqyrtim dhe i kundërshtojmë si të pa bazuara, duke marrë parasysh se Projektet janë vlerësuar nga Juria Profesionale e caktuar me Vendim të ZKA-se, në përputhje me nenin 80 të LPP-se. Juria ka qene në përbërje prej tre inxhinierëve, dy (2) Arkitekt dhe një (1) inxh. e Ndërtimtarisë. Vlerësimin e projekteve e konsiderojmë si profesional dhe përzgjedhja e projekteve nga juria është mandatorë për AK-MSH.

Sa i përket pretendimit të parë Mosrespektimi i rregullativës ligjore në fuqi të planifikimit hapësinor dhe kriterëve hapësinorë, pjesërisht kemi të drejtë, meqenëse ky detaj është cekur edhe nga juria profesionale e vlerësimit, por kjo mbetet të korrigjohet në fazën tjetër të kompletimit të projektit detaj.

Sa i përket pretendimit të dytë Mosrespektimi i Detyrës Projektuese, specifikave teknike dhe kriterëve profesionale të projektimit të ndërtesave shëndetsore, nuk kemi të drejtë, meqenëse edhe projekti juaj ka mjaftë mangësi sa i përket specifikave teknike dhe kriterëve profesionale të projektimit të

ndërtesave shëndetësorë, te cilat janë listuar nga komisioni, te cilat janë defekte esenciale dhe te pa tejkalueshme për këtë objekt:

Sipërfaqet e paraqitura si bruto janë të llogaritura neto, rrjedhimisht kemi rreth 200-300m² më shumë se sa është kërkuar maksimalisht me detyrë projektuese

- Bodrumi ka rreth 30% ndriçim natyral vetëm në planimetri sepse në prezantimin 3 D është I mbyllur nga të gjitha anët
- Nuk është marrë parasysh terreni – Prerjet dhe fasadat kanë teren të rrafshet me Përdhesen
- Dyert e ashensorëve të ngushta
- Zgjidhje joadekuate tek hapësira për administrim të Laboratorit
- Dyert e WCve për Hendikep janë të ngushta
- Organizim jo racional tek shërbimet e diagnostikues

Këto janë vetëm disa me kryesoret e cekura nga komisioni, përndryshe si faktor kyç tek projekti juaj është edhe aspekti ekonomik i mirëmbajtës se objektit gjate jetëgjatësisë se objektit.

Sa i përket pretendimit te trete Mosrespektimi i Detyrës Projektuese dhe dispozitat ligjore të RREGULLORES Nr. 24/2012 PËR NORMAT TEKNIKE PËR MBROJTJE NGA ZJARRI TË OBJEKTEVE TË LARTA, nuk keni te drejte, meqenëse ky dhe shume aspekte teknike te cekura ne kërkesën tuaj për rishqyrtim si mangësi e projekteve tjera, nuk janë obligim i kësaj faze te projektit ideor, por janë obligim i kompanisë fituese ne fazën e me vonshme te përgatitjes se projektit detaj.

Sa i përket pretendimit te katërt Vlerësimi jo i bazuar ne 5 nenkriteret e vleresimit per koncept projektet nuk keni te drejte, meqenëse Juria profesionale i ka potencuar mangësitë e secilit projekt kur e ka hartuar listën e përshkrimit te projekteve dhe ju si ankues jeni bazuar ne atë liste për ti kontestuar projektet tjera, por komisioni nuk i ka potencuar përparësitë (avantazhet) ne mes projekteve, ku projekti i përzgjedhur ne vendin e pare me shifrën 8485, i ka plotësuar me se shumti nevojat e AK, me shume përparësi funksionale, estetike, materializimi, etj, ne raport me projektet tjera.

Sa i përket pretendimit qe Juria profesionale ju ka diskriminuar juve si OE dhe duke i vlerësuar me pike maksimale projektet qe nuk kane respektuar kërkesat e detyrës projektuese dhe rregullativën ligjore ne fuqi dhe sipas jush duke shkelur LPP-ne, konsiderojmë se nuk keni te drejte, meqenëse juria ka qene profesionale dhe ka vlerësuar drejte për ta zgjedhur projektin me te kompletuar ne mesin e 10 projekteve ne konkurrencë. Sa i përket pozicionimit te projektit tuaj si i 7-ti ne liste, kjo mund te jete e diskutueshme, por qe nuk ndikon ne epilogun e procesit p.sh. se a jeni nr. 7 apo nr. 4 ne mesin e projekteve, andaj nuk është dhe aq relevante.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit